

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI NË LËMIN INFORMATIKË DHE GJUHËT PROGRAMORE DHE SISTEMET NË PROGRAMIN STUDIMOR INFORMATIKË TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MATEMATIKO NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 34, 35 dhe 36 Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, në lidhje me Konkursin për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëmin Informatikë dhe Gjuhët programore dhe sistemet (11000, 11003 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **18. 11. 2023** në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. XI. 2023**, sollti Vendim me nr. **15-2191/1** të datës **30. XI. 2023**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Agon Memeti** (kryetar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. Dr. Florim Idrizi** (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. Dr. Eip Rufati** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës,

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

R A P O R T

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëmin Informatikë dhe Gjuhët programore dhe sistemet (11000, 11003 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidati:

Mr. Sc. Avni Rustemi

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidati Mr.Sc. Avni Rustemi ka lindur më 31 janar 1993 në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollën fillore e ka kryer në shkollën fillore "Kirili dhe Metodij" në Tetovë, ndërsa shkollën e mesme në gjimnazin "Kiril Pejçinoviç" në vitin 2011.

Po në të njëjtin vit (2011) është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në Universitetin e Tetovës, në programin studimor Informatikë, dhe ka përfunduar studimet në vitin 2015 duke fituar titullin "Inxhinier i diplomuar i Informatikës" me notë mesatare 9.88, duke u vlerësuar si studenti më i mirë i gjeneratës.

Gjatë studimeve ka marrë pjesë në realizimin e disa projekteve, ku vlen të theksohet pjesëmarrja në projektin *Google Your Future: Hackathon*.

Pas përfundimit të studimeve të ciklit të parë, kandidati bëhet pjesë e projektit *Seeds for future*, organizuar nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë dhe kompania Huawei, ku ka marrë pjesë në një trajnim 15-ditor në Kinë. Studimet e ciklit të dytë i ka vazhduar në Universitetin e Tetovës duke shfrytëzuar bursë studentore, dhe të njëjtat i ka përfunduar në vitin 2017 me temën "Modifikimi i algoritmeve për sortim dhe aplikimi i tyre në të dhëna të mëdha (Big Data)", me notë mesatare 10.00, ku ndër të tjera vlen të theksohet se kandidati arriti të krijojë një algoritëm të ri për sortim, i cili ka treguar rezultate shumë të mira të sortimit.

Në vitin akademik 2018/2019 është regjistruar në ciklin e tretë të studimeve të doktoraturës në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Teknologjive Informatike në Universitetin "Kirili dhe Metodij" në Shkup, në programin e studimor - Inxhinieri Elektrike dhe Teknologji Informatike.

Nga viti 2015, kandidati është i punësuar në Universitetin e Tetovës, në departamentin e informatikës, si asistent me kohë të caktuar (part-time) dhe nga viti 2019, si asistent i rregullt.

Në periudhën 2016/17 ka qenë i punësuar për 16 muaj në Qendrën Shtetërore të Provimeve në Shkup, si administrator i IT qendrës.

Në periudhën 2019/20, në kohëzgjatje prej 10 muajsh, ka qenë i angazhuar në kabinetin e drejtorit të përgjithshëm në Drejtorinë e Ndërmarrjes Publike për Infrastrukturë Hekurudhore – Shkup.

Në periudhën 2020/21 ka qenë zëvendësudrejtor i Agjencisë për Rini dhe Sport në Shkup për 13 muaj.

Gjithashtu ka marrë pjesë në disa seminare, kurse dhe trajnime të organizuara nga institute të ndryshme private dhe publike.

Deri më tani kandidati ka publikuar një numër të konsiderueshëm të hulumtimeve shkencore nëpër revista dhe konferenca ndërkombëtare.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Në vitin akademik 2015/2016 kandidati Avni Rustemi është punësuar si asistent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Tetovës me kohë të caktuar (part-time), programi studimor: Informatikë.

Më 30 dhjetor 2019 është zgjedhur në titullin mësitor-shkencor asistent i rregullt në programin studimor Informatikë në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore në Universitetin e Tetovës.

Nga viti akademik 2019/2020 deri në vitin akademik 2023/2024, ka mbajtur ushtrime në lëndët vijuese: Teoria e Kodimit dhe Kriptografia, Dizajni dhe Analiza e Algoritmeve, Sistemet e Shpërndara, Hyrje në Kriptografi, Struktura e të dhënave, Softuer arsimor, Sistemet e informacionit në turizëm, Sistemet e informacionit për vendimmarrje, Menaxhimi i sistemeve të informacionit, Ueb dizajn dhe ueb programim dhe Softuer sistemor.

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:

a) Rezultatet shkencore të kandidatit që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:

Kandidati Mr.Sc. Avni Rustemi, në aspektin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, njihet me disa punime shkencore që janë rezultat i kërkimit shkencor gjatë përgatitjes së punimeve të diplomës, masterit dhe doktoraturës në vazhdimësi. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatit Avni Rustemi fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës me titull: „Sistem online për kompanitë e sigurimeve në Maqedoninë e Veriut“ në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë dhe punimin e magjistraturës me titull: „Modifikimi i algoritmeve për sortim dhe aplikimi i tyre në Big Data“ mbrojtur në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore , programi studimor Informatikë, drejtimi profesional.

b) Punime shkencore në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. Rustemi, F. Dalipi, V. Atanasovski and A. Risteski, "A Systematic Literature Review on Blockchain Based Systems for Academic Certificate Verification," in IEEE Access, vol. 11, pp. 64679-64696, 2023, doi: 10.1109/ACCESS.2023.3289598.
2. Avni Rustemi, Vladimir Atanasovski, Aleksandar Risteski, "Security and transparency of blockchain systems in higher education institutions", Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol 8, No.15-16, ISSN(print): 2545-4072,ISSN (online):2671-3039.
3. Festim Halili, Ilia Ninka, Avni Rustemi ,Merita Kasa Halili; "Finding CPM and PERT for implementing a service ranking model"; Bulletin of Natural Sciences, Faculty of Science Tirana, ISSN:2305-882X, issue. 14.
4. Festim Halili, Avni Rustemi, "Predictive Modeling: Data Mining Regression technique applied in prototype", International Journal of Computer Science and Mobile Computing, IJCSMC, Vol.5 Issue.8, pg. 207-215, ISSN: 2320-088X.
5. Festim Halili, Avni Rustemi, "Bringing semantics to services: the OWL-s", Bulgarian Journal for Engineering Design, BJED, issue 30, pg. 17-25, ISSN:1313-7530.
6. Florim Idrizi, Avni Rustemi, "Analysis of some several elements of cryptography and proposing a new model for data security", BJED, issue 30, pg. 57-61, ISSN:1313-7530.

7. Festim Halili, Avni Rustemi, "Modeling of an e-business system", International Journal of Computers and Technology, IJCT, Vol. 15 No.12, pg.7308-7315, ISSN:2277-3061.

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. Rustemi, V. Atanasovski and A. Risteski, "Design of the Blockchain System for the Generation and Verification of Diplomas," 2023 XXXII International Scientific Conference Electronics (ET), Sozopol, Bulgaria, 2023, pp. 1-6, doi: 10.1109/ET59121.2023.10279743.
2. A. Rustemi, V. Atanasovski, A. Risteski and B. Popovski, "Analysis of Blockchain Platforms for Generation and Verification of Diplomas," 2023 12th Mediterranean Conference on Embedded Computing (MECO), Budva, Montenegro, 2023, pp. 1-4, doi: 10.1109/MECO58584.2023.10154926.
3. A. Rustemi, V. Atanasovski, A. Risteski and P. Latkoski, "Challenges of Blockchain in Higher Education Institutions for Protection Against Diploma Forgery," 2023 International Balkan Conference on Communications and Networking (BalkanCom), İstanbul, Türkiye, 2023, pp. 1-6, doi: 10.1109/BalkanCom58402.2023.10167986.
4. A. Rustemi, V. Atanasovski and A. Risteski, "Identification During Verification Of Diplomas In The Blockchain System," 2023 30th International Conference on Systems, Signals and Image Processing (IWSSIP), Ohrid, North Macedonia, 2023, pp. 1-5, doi: 10.1109/IWSSIP58668.2023.10180241.
5. A. Rustemi, V. Atanasovski and A. Risteski, "Overview of Blockchain Data Storage and Privacy Protection," 2022 International Balkan Conference on Communications and Networking (BalkanCom), Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, 2022, pp. 90-94, doi: 10.1109/BalkanCom55633.2022.9900867.
6. Avni Rustemi, Vladimir Atanasovski and Aleksandar Risteski, "Framework for Using BigchainDB in Software Application", held at the Faculty of Computer Science and Engineering, Skopje, North Macedonia 5-6th May, 2022, pp.64-69, ISBN 978-608-4699-15-6.
7. Aleksandar Risteski., Avni Rustemi., "The Application of the Internet of Things in Everyday Equipment Affects to Have a More Efficient and Quality Life", ETAI 2021, online conference, 23-24 September 2021, pp.242-247, ISSN:2545-4489.
8. Florim Idrizi, Avni Rustemi, Fisnik Dalipi; "A new modified sorting algorithm: A comparison with state of the art", 6th Mediterranean Conference on Embedded Computing (MECO), IEEE, Bar, Montenegro.
9. Avni Rustemi, Nderim Zeqiri, "Analysis and flexibility of interoperability between application program and database", Second International Conference of Applied Sciences, University of Tetova, Tetovo.
10. Festim Halili, Avni Rustemi, "Importance of Data Mining techniques for the development of business", 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics (abstract), University of Tetovo, Tetovo.

4. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidati **Mr. Sc. Avni Rustemi** në përputhje me Rregulloren e kriterëve dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, i plotëson të gjitha kushtet për rizgjedhjen e tij në thirrjen mësimore-shkencore **asistent**.

Në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësi në Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit e Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidatin **Mr. Sc. Avni Rustemi** ta rizgjedh në thirrjen mësimore-shkencore **asistent** në lëmin Informatikë dhe Gjuhë programore dhe sistemet (11000, 11003 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, dhjetor 2023

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Agon Memeti (kryetar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës,

2. Prof. Dr. Florim Idrizi (anëtar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës

3. Prof. Dr. Eip Rufati (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore të Universitetit të Tetovës

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Avni Ekrem Rustemi**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Informatikë dhe Gjuhët programore dhe sistemi (11000, 11003 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR – ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Informatikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,88 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 10,00 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2023 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI NË LËMIN INFORMATIKË, SISTEMET E INFORMATIONIT DHE PROGRAMIMI NË PROGRAMIN STUDIMOR INFORMATIKË TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 82/18), nenit 32, 34, 35 dhe 36 Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, në lidhje me Konkursin për zgjedhje të një asistenti në lëminë Informatikë, Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **18. XI. 2023** në gazetën ditore "Koha" dhe "Sloboden Peçat", Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. XI. 2023**, solli Vendim me nr. **15-2189/1** të datës **30. XI. 2023**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florim IDRIZI** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. Dr. Florinda IMERI** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 3. Doc. Dr. Shkurte LUMA-OSMANI** (anëtar) - Docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje të një asistenti në lëminë Informatikë, Sistemet e informacionit dhe programimi (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidatja:

Mr. Sc. Ermira Memeti

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Kandidatja Ermira Memeti ka lindur më 25.VII.1997 në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollimin fillor e kreu në shkollën fillore „Naim Frashëri“ në Tetovë nga viti 2004 deri 2012. Shkollimin e mesëm e kreu në Gjimnazin „Kiril Pejçinoviç“ në Tetovë, drejtimi: matematiko-natyrorë (A), me sukses të shkëlqyeshëm nga viti 2012 deri 2016.

Në vitin akademik 2016/2017 është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë. Më datë 07.X.2020 mbrojti me sukses punimin e diplomës me temë: „UT Alumni App“ dhe fitoi titullin *inxhinier i diplomuar i Informatikës* me notë mesatare 9,90.

Pas mbarimit të studimeve deridiplomike, kandidatja Ermira Memeti në vitin akademik 2020/2021 është regjistruar në studimet pasdiplomike (master) në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë. Më 07.XII.2022, mbrojti me sukses tezën e magjistraturës me titull: „Zhvillimi i modelit të bazuar në SOA për shërbimet e menaxhimit të infrastrukturës së agjensioneve turistike“ dhe fitoi titullin *magjistër i informatikës* me notë mesatare 10,00.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Në vitin akademik 2021/2022 kandidatja Ermira Memeti angazhohet me kontratë në vepër (part-time) si asistente në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë.

Gjatë angazhimit në Universitetin e Tetovës, kandidatja Ermira Memeti ka mbajtur ushtrimet në lëndët:

- Sistemet Multimediale dhe Aplikacionet (Informatikë Biznes)
- Teknologjitë multimediale (Programi studimor Informatikë)
- Softuer Sistemor (Programi studimor Informatikë)
- Bazat e programimit dhe bazat të të dhënave (Fakulteti i Shkencave të zbatuara)
- Hyrje në programim (Fakulteti i Shkencave të zbatuara)
- Media dhe kompjuteri (Fakulteti Juridik)
- Bazat e informatikës 1 (Fakulteti i Arteve)
- Hyrje në Informatikë (Fakulteti Filozofik dhe Pedagogjik)
- Komponentët Softuerike (Programi studimor Informatikë)
- Menaxhimi me projektet softuerike (Programi studimor Informatikë)
- Sistemet e informacionit (Programi studimor Informatikë)

Kandidatja Ermira Memeti gjithashtu është angazhuar edhe në:

- Shtator 2020 – dhjetor 2022 me kontratë (part-time) si instruktore në „Shkollën Digjitale” në Tetovë
- Shtator 2020 – tetor 2021 si Biznes Analiste në kompaninë Zvicerane „Bilateral Group“
- Tetor 2021 si CRM zhvilluese e softuerëve (CRM Software Developer) në kompaninë Zvicerane “Funk Insurance Brokers AG”

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:

a) Rezultatet shkencore të kandidatës që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:

Kandidatja Mr. Sc. Ermira Memeti në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore njihet me disa punime shkencore të cilat rrjedhin si rezultat i kërkimeve shkencore gjatë periudhës së përgatitjes së punimit të diplomës dhe magistraturës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës Ermira Memeti, fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës me titull: „UT Alumni App“ në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 07.X.2020. Veprimtaria e saj në fushën e shkencës vazhdon me punimin e magistraturës me titull: „ Zhvillimi i modelit të bazuar në SOA për shërbimet e menaxhimit të infrastrukturës së agjensioneve turistike“ mbrojtur në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 07.XII.2022.

b) Pasqyra e konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. Florinda Imeri, Ermira Memeti, Agon Memeti: „Streamlining postal services in North Macedonia: A Case Study“, *Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT*, 15-16/2023, f. 234-243, ISSN: 2545-4072 (Print), ISSN: 2671-3039 (Online)
2. Enes Bajrami, Eip Rufati, Florim Idrizi, Ermira Memeti, Lendina Rushani: “E-thesis repository system”, *Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT*, 11-12/2021, f.48-50, ISSN: 2545-4072 (Print), ISSN: 2671-3039 (Online)
3. Enes Bajrami, Agon Memeti, Ermira Memeti: “Analysis and comparison of online platforms for plagiarism: Comparing the evaluation system of the ministry of education and science of North Macedonia with other online systems”, *Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT*, 13-14/2022 f.51-57, ISSN: 2545-4072 (Print), ISSN: 2671-3039 (Online)

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: „Categorization and the ethical behavior of Dark Patterns“, Universiteti i Tetovës, **15-17 maj 2019.**

2. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: „E-thesis repository system“, Universiteti i Tetovës, **18-19 maj 2022**.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “Analysis and comparison of online platforms for plagiarism: Comparing the evaluation system of the ministry of education and science of North Macedonia with other online systems “, Universiteti i Tetovës, **18-19 maj 2022**.
4. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “Education system after Covid-19, Case Study: University of Tetova “, Universiteti i Tetovës, **18-19 maj 2022**.
5. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “The impact of amulni applications for universities. Case Study: UBT “, UBT Kosovë , **29-30 tetor 2022**
6. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “Rapid Application Development vs Agile Methodologies, Case Study: Creating an alumni app for University of Tetova “, Universiteti i Tetovës , **18-19 maj 2022**
7. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “Streamlining postal services in North Macedonia: A Case Study “, Universiteti i Tetovës, **17-19 maj 2023**
8. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e Pestë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore me temë: “Stem education and high school students’ attitudes, career perceptions and interest in information technology fields“, Universiteti i Tetovës, **17-19 maj 2023**

3.3. Pjesëmarrje si vlerësues (reviewer) në punime shkencore

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje si vlerësues në “The International Conference on Decision Aid Sciences and Applications “, MAE Fah Laung University, 23-25 mars 2022
2. **Certifikatë** për pjesëmarrje si vlerësues në “The International Journal of Computing and Digital Systems “, University of Bahrain, 2022

4. Veprimtaria profesionale-aplikative:

a) Pjesëmarrëse në promovimin e fakultetit

Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i ofertës akademike të programit studimor Informatikë, 2020, 2021, 2022, 2023.

5. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidates, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidaten **Mr. Sc. Ermira Memeti** ta zgjedh në thirrjen mësimore-shkencore **asistent** në lëmin Informatikë, Sistemet e informacionit dhe programimi, (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Informatikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, dhjetor 2023

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Florim IDRIZI (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,

2. Prof. Dr. Florinda IMERI (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,

3. Doc. Dr. Shkurte LUMA-OSMANI (anëtar) - Docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidatja: **Ermira Memeti**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Informatikë, Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR – ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i Informatikës Emri i fushës shkencore: Informatikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,90 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 10,00 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 18.07.2023 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI PËR LËMIN SHKENCORE MATEMATIKË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 178/2021), nenit 32, 34, 35 dhe 36, Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. 12. 2021**, në lidhje me Konkursin për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëmin Matematika e zbatuar dhe modelim matematikor, dhe Të tjera (10912, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më 18. 11. 2023 në gazetata ditore „Koha“, „Sloboden Peçat“ dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. 11. 2023**, solli Vendim me nr. **15-2195/1** të datës 30.11. 2023, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Krutan RASIMI** (kryetar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. Dr. Flamure SADIKI** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 3. Doc. Dr. Emin DURMISHI** (anëtar) – docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollloi materialin e konkursit, titullit të lartë përmendur i paraqet këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëmin Matematika e zbatuar dhe modelim matematikor, dhe Të tjera (10912, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në afatin e paraparë është paraqitur vetëm një kandidate, edhe atë Miranda Xhaferi, asistente në departamentin e Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Miranda Xhaferi u lind më 26.02.1992 në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut. Shkollën fillore e kreu në Sh.F.K. "Luigj Gurakuqi" në Zhelinë, në vitin 2006, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjimnazi "Kiril Pejçinoviç", drejtimi matematikë-natyror, në Tetovë, gjatë periudhës 2006-2010 me sukses të shkëlqyeshëm.

Në periudhën 2010-2014 studioi në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Programin studimor Matematikë në Universitetin e Tetovës, ku diplomoi me notë mesatare 9.35 me temë të diplomës "Studimi i vijave të gradës së dytë" dhe fitoi titullin **Profesor i diplomuar i matematikës**. Miranda Xhaferi si studente e dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore që nga viti i dytë i studimeve.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si bashkëpunor i jashtëm (asistent part-time) në Programin studimor Matematikë.

Në vitin 2019, Miranda Xhaferi mbaron studimet e ciklit të dytë në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Programin studimor Matematikë në Universitetin e Tetovës, me notë mesatare **9.60**, me temë të magistraturës "Zgjerime të teoremës Fuglede-Putnam", dhe fiton titullin **Magjistër i Matematikës**.

Pas kryerjes së ciklit të dytë të studimeve, në vitin akademik 2019/20, kandidatja regjistron studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin "Kirili dhe Metodi" në Shkup, në drejtimin Matematikë e zbatuar.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Në vitin akademik 2016/2017 kandidatja Miranda Xhaferi angazhohet me kontratë në vepër (part-time) si asistent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Matematikë dhe Fizikë kurse në 2021 edhe në programin studimor Informatikë.

Më 29. 12. 2020 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore *asistent* për lëndët mësimore në fushën e Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Tetovës. Nga viti akademik 2016/2017 deri në vitin akademik 2023/2024 ka mbajtur ushtrimet nga kurset: *Analiza Matematike I & II* (6/5 semestra), *Bashkësitë dhe Logjika* (8 semestra), *Algjebër Lineare I* (7 semestra), *Teoria e Grafeve* (1 semestër), *Gjeometri Elementare* (2 semestra) (programi studimor Matematikë), *Analiza Matematike I & II* (8/7 semestra), *Algjebër Lineare* (7 semestra), *Metodat Matematikore në Fizikë I* (6 semestra) (programi studimor Fizikë) dhe *Probabilitet dhe Statistikë* (1 semestër) (programi studimor Informatikë). Ajo ka realizuar edhe ligjëratat nga kursi *Gjeometri Elementare* (programi studimor Matematikë).

Përveç ligjëratave dhe ushtrimeve, kandidatja Miranda Xhaferi, realizon edhe konsultime me studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Programin studimor Matematikë, Fizikë dhe Informatikë të lëndëve përkatëse në studimet deridiplomike.

Njëkohësisht, kandidatja Miranda Xhaferi nga viti 2016 deri në vitin 2020 ka punuar si mësime dhënëse e lëndës së matematikës në Sh.F.K. " Istikball" - Tetovë. Në vitin 2018, kandidatja jep Provimin profesional për mësime dhënëse në lëndën e matematikës dhe pajiset me Çertifikatë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2019, kandidatja ka qenë e angazhuar si kordinatore e garave rajonale të matematikës të organizuara nga UMM. Miranda Xhaferi poashtu ka punuar në Qendrën private për mësimin e gjuhëve të huaja dhe trajnimeve profesionale në sfera të ndryshme, Vision Academy, Tetovë, në periudhën kohore shtator- dhjetor, 2015.

Miranda Xhaferi në periudhën 2013-2014, realizon praktikë profesionale në Sh.F.K. " Naim Frashëri", Tetovë si dhe në Sh.M.K. Gjinnazi " Kiril Pejçinoviç", Tetovë , për të cilën më pastaj është pajisur me Vërtetim për praktikë të kryer

Kandidatja për qëllime profesionale në mënyrë aktive shërbehet me gjuhët e huaja angleze dhe sllave. Në aspektin e njohurive teknologjike ajo ka njohuri të mjaftueshme në gjuhët programore C++ dhe LaTeX si dhe programin Mathematica dhe paketën Office.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë në vazhdimësi me hulumtim në fushën e matematikës (përkatësisht Modeling Matematikor dhe Matematikë e zbatuar), dhe informatikës si dhe në fushën e edukimit dhe arsimimit. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës përbëhet nga artikuj shkencorë të botuar në revista shkencore ndërkombëtare, me pjesëmarrje në tubime shkencore të nivelit kombëtarë e ndërkombëtarë. Kjo veprimtari e kandidatës është paraqitur më poshtë.

A. Artikuj shkencorë

1. Ibraimi, Alit and Sadiki, Flmure and **Xhaferi, Miranda** (2017) *CONSTRUCTION OF LATIN SQUARES FROM AN AFFINE PLANE OF ORDER N*. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol.2 No 4. pp. 188-193. ISSN: 2545-4072.
2. Kadriu, Ibish and Xhaferi, Sermijete and **Xhaferi, Miranda** (2017) *INTEGRATED INTERETHNIC EDUCATION AND DEVELOPMENT OF INTERCULTURAL SKILLS*. International Journal of Social and Human Sciences, Philosophica, Vol.4 / No. 7 / ISSN: 1857-9272, Tetovo, North Macedonia.
3. Kadriu, Ibish and Xhaferi, Sermijete and **Xhaferi, Miranda** (2018) *IDENTITY AND CULTURAL*

DIVERSITY IN TETOVO. PHILOSOPHICA International Journal of Social and Human Sciences, 5 (9). pp. 49-54. ISSN 2671-3020.

4. Misimi, V., & **Xhaferi, M.** (2018). A SURVEY INTERNET OF THINGS (IOT) - APPLICATIONS, BENEFITS& CHALLENGES. *KNOWLEDGE - International Journal*, pp. 1705–1711. [Vol. 28 No. 5 \(2018\): Knowledge in practice](#)
5. **Xhaferi, M.**, Ibraimi, A., Sadiki, F. and Rasimi, K. (2019) *RELATION BETWEEN MULTIALGEBRAS AND BOOLEAN ALGEBRAS WITH OPERATOR*. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 4 (7-8). pp. 183-188. ISSN 2671-3039.
6. Xhaferi, Astrina and Idrizi, Florim and **Xhaferi, Miranda** (2020) *ONLINE PAYMENT SYSTEMS FOR E-BANKING AND BLOCKCHAIN TECHNOLOGY*. ECONOMIC VISION - International Scientific Journal in Economics, Finance, Business, Marketing, Management and Tourism, 7 (13-14). pp. 63-70. ISSN 2545- 4544.
7. **Xhaferi, M.**, Salihi, Y., & Misimi, V. (2021). SOLVING INITIAL-VALUE PROBLEM BY COMPARING LAPLACE TRANSFORM AND AN NUMERICAL PREDICTOR-CORRECTOR METHOD. *KNOWLEDGE - International Journal*, pp. 475–480. [Vol. 49 No. 3 \(2021\): Knowledge in Practice](#)
8. SALIHI, Ylldrita and **XHAFERI, Miranda** and RASIMI, Krutan and M. JONUZI, Verda (2022) *A PREDICTOR-CORRECTOR METHOD FOR SOLVING DIFFERENTIAL EQUATIONS OF FRACTIONAL ORDER*. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 7 (13-14). pp. 158-165. ISSN 2671-3039.
9. SADIKI, Flamure and IBRAIMI, Alit and SALIHI, Ylldrita and **XHAFERI, Miranda** (2022) *THREE-DIMENSIONAL LINEAR CODES AND COORDINATED FINITE PROJECTIVE PLANE*. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 7 (13-14). pp. 121-129. ISSN 2671-3039.
10. SADIKI, Flamure and RASIMI, Krutan and IBRAHIMI, Alit and SALIHI, Ylldrita and **XHAFERI, Miranda** (2023). *APPROACHES DEVELOPED TO SOLVE FRACTIONAL DIFFERENTIAL EQUATIONS*. [Vol. 8 No. 1 \(2023\): European Journal of Engineering and Natural Sciences \(EJENS\)](#), pp. 83-90. ISSN: 2458-8156.
11. Salihi, Y., **Xhaferi, M.**, Rasimi,K., Ibraimi,A. and Sadiki, F. (2023) *RK4 AND VECTORIAL RK4 USED TO ANALYZE A MODIFIED FORM OF FRACTIONAL ORDER LORENZ SYSTEM*. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 8, No. 15-16, pp. 425-431.

B. Tubime shkencore

1. I. Kadriu, S. Xhaferi, **Miranda Xhaferi**, “*Integrated interethnic education and development of intercultural skills*”, 4th ICFPH of UT, Education in societies with cultural diversity, 28 Oct 2016, Tetovo, North Macedonia.
2. I. Kadriu, S. Xhaferi, **Miranda Xhaferi**, “*Identity and cultural diversity*”, 5th ICFPH of UT, Meeting point and cultural divergences in the Balkans, 27-28 Oct, 2017, Tetovo, North Macedonia.
3. A. Ibraimi, F. Sadiki, **Miranda Xhaferi**, “*Construction of latin squares from an affine plane of order n*”,

1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics of UT, 16-17 June, 2017, Tetovo, North Macedonia.

4. **Miranda Xhaferi**, A. Ibraimi, F. Sadiki, “*Some extensions of Fuglede-Putnam Theorems*”, 2nd International Conference of Natural Sciences and Mathematics of UT, 22-23 June, 2018, Tetovo, North Macedonia.
5. V. Misimi, **Miranda Xhaferi**, Y. Salihi, “*A survey: Internet of things (IOT)- Applications. Benefits & Challenges*”, 19th International Scientific Conference, Knowledge in Practice, 14 Dec 2018, Bansko, Bulgaria.
6. **Miranda Xhaferi**, A. Ibraimi, F. Sadiki, K. Rasimi, “*Relation between multialgebras and Boolean algebras with operator*”, 3rd ICNSM of UT, International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, 15-17 May, 2019, Tetovo, North Macedonia.
7. Y. Salihi, **Miranda Xhaferi**, K. Rasimi, V. M. Jonuzi, “*A predictor-corrector method for solving differential equations of fractional order*”, 4th ICNSM of UT, International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, 18-19 May, 2022, Tetovo, North Macedonia.
8. Y. Salihi, **Miranda Xhaferi**, K. Rasimi, A. Ibraimi, F. Sadiki, “*RK4 and vectorial RK4 used to analyze a modified form of fractional order Lorenz system*”, 5th ICNSM of UT, International Congress on Natural, Health Sciences and Technology, 15-17 May, 2023, Tetovo, North Macedonia.
9. F Sadiki, K Rasimi, A Ibraimi, Y. Salihi, **Miranda Xhaferi**, “*Approaches Developed to Solve Fractional Differential Equations.*” 9th International Conference on Engineering and Natural Science, May 17-21, 2023, Sarajevo, Bosnia and Herzegovina.

IV. VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

4.1. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

Gjatë angazhimit si part-time në Universitetin e Tetovës nga viti 2016 deri 2019, si dhe gjatë angazhimit si asistent i rregullt nga viti 2020 deri 2023 kandidatja ka marrë pjesë në organizimin e aktiviteteve Ditët e Hapura në Universitetin e Tetovës në prezantimin e programit studimor Matematikë.

Ndërsa në vitet akademike, 2021- 2022 dhe 2022-2023 kandidatja ka qenë e angazhuar në promovimin e Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

V. VEPRIMTARI ME INTERES TË PËRGJITHSHËM

Kandidatja Miranda Xhaferi ka qenë edhe pjesë e trajnimeve të ndryshme gjatë veprimtarisë së saj mësimore, ndër të cilat do të përmendim disa më me rëndësi si pjesëmarrje në trajnimet:

- “Critical thinking and problem-solving”, i organizuar nga British Council, në periudhën kohore 13-15 Janar 2020, Tetovë.
- “micro:bit basics course “ , British Council, Janar, 2020.
- “Application of coding in the teaching practice and practical examples and activities “, 21st Century Schools programme, British Council, Shkurt, 2020.
- “Inclusive Education”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës- BZHA, Tetor, 2019.
- “Realization of teaching using ICT for learning”, Ministria e Arsimit dhe Shkencës- BZHA, Gusht, 2020.
- Training for National Platforms for Distance Learning, “Learning Management System Platforms, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Shtator, 2020.
- Conference delegate, “The New Normal Education post COVID-19 “, T4.Education, Maj, 2020.
- Edmodo Training, “Edmodo Basics Course”, Edmodo, Qershor, 2020.

VI. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidatja **Asst. Mr. Miranda Xhaferi**, në përputhje me Rregulloren e kriterëve dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, nr. 01-4309/2 datë 01. 12. 2021, i plotëson kushtet ligjore dhe profesionale për rizgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **asistent**.

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore – shkencore, publikimin e punimeve shkencore e profesionale, referimet në konferencat ndërkombëtare, përvojës në punën arsimore, dhe aktivitetit të përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë që Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidaten **Asst. Mr. Miranda Xhaferi** ta rizgjedh në thirrjen mësimore-shkencore **asistent** në lëmin **Matematika e zbatuar dhe modelim matematikor**, dhe **Të tjera** (10912, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Matematikë të Fakultetit të Shkencave Matematike- Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Dhjetor, 2023

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Krutan RASIMI (kryetar) -profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës

2. Prof. Dr. Flamure SADIKI (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,

3. Doc. Dr. Emin DURMISHI (anëtar) – docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Miranda Liman Xhaferi**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Matematika e zbatuar dhe modelim matematikor, Të tjera (10912, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR - ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Matematikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,35 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 9,60 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2022 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI NË LËMINË FIZIKË DHE BIOFIZIKË NË PROGRAMIN STUDIMOR FIZIKË TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 34, 35 dhe 36 Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. 01-4309/2 e datës 01. 12. 2021, në lidhje me Konkursin për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëminë **Fizikë** dhe **Biofizikë** (10300, 10303 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **18. 11. 2023** në gazetën ditore „Koha“, „Sllloboden Peçat“ dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. 11. 2023**, solli Vendim me nr. **15-2192/1** të datës **30. 11. 2023**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

1. Prof. dr. Neset IZAIRI (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,
2. Doc. dr. Kimet JUSUFI (anëtar) - docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës
3. Prof. dr. Fadil AJREDINI - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

RAPORT

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëminë **Fizikë** dhe **Biofizikë** (10300, 10303 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidatja **Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi**, asistente në departamentin e Fizikës në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetin e Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Ass. Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi ka lindur më 16 shkurt 1982 në fshatin Përshefcë, Komuna e Tercës, Tetovë, ku edhe ka mbaruar shkollën fillore. Shkollën e mesme, Gjumnazin “Kiril Pejçinoviç” e ka kryer në vitin 2001/2002 në Tetovë.

Në vitin 2001/02 është regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë në fizikë, drejtimi fizikë inxhinierike, ku edhe ka fituar titullin *Bachelor i fizikes Inxhinjerike*. Vlen të theksohet se kandidati ka qene edhe bursiste e Universiteti te Prishtinës si studente e dalluar.

Në vitin akademik 2010/2011 ka regjistruar studimet pasdiplomike në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Prishtinë në drejtimin *Fizikën e përgjithshme*. Pasi i ka dhënë me sukses të dalluar të gjitha provimet e parapara sipas programit, më 12. 10. 2015 ka mbrojtur temën e masterit me titull *“Formulimi bashkëkohor i modelit standard”* ku është vlerësuar me notë maksimale dhe ka fituar titullin *“Magjistër i Shkencave të Fizikës”*.

Në vitin akademik 2017/2018 ka regjistruar studimet e doktoraturës (cikli i tretë) në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin “Shën Kiril dhe Matodij” në Shkup ku i ka dhënë të gjitha provimet e parapara sipas plan-programit dhe aktualisht është duke punuar punimin e disertacionit.

Gjatë periudhës së arsimit të mesëm dhe të lartë ka marrë pjesë në gara të ndryshme të fizikës dhe matematikës, ku edhe ka fituar disa diploma dhe mirënjohje.

II. VEPRIMTARIA EDUKATIVE ARSIMORE

A. Mësimdhënie

Ass. Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi, ka ushtruar profesionin e arsimtarit në shkolla të mesme si dhe të asistentit në FSHMN, si në vijim.

- Prej vitit 2008/2009 deri më 2011/2012 ka punuar si profesor i fizikës në Shkollën e Mesme profesionale “Moshë Pijade” në Tetovë, në ndërkohë ka ligjëruar lëndën e fizikës në shkollën mesme e Integruar dygjuhësore “Nansen Dialogue Centre Skopje” në Prelubisht, komuna e Jogunovcës.
- Gjatë vitit shkollor 2008/2009 ka mbajtur mësim edhe në shkollën e mesme të mjekësisë “Nikola Shtein” në Tetovë.
- Nga viti shkollor 2012/2013 deri më 2014/2015, ka punuar si profesor i fizikës në Gjumnazin e Tetovës “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë.
- Me ndarjen e gjumnazit të Tetovës në dy gjumnaze në vitin shkollor 2014/2015 është transferuar në Gjumnazin “7 Marsi” në Tetovë.

Në ndërkohë, për shkak të nevojave të katedrës së fizikës për kuadër të ri, në vitin akademik 2010/2011 e në vijim, ka qenë e angazhuar si asistente Part-time në FSHMN të Universitetit e Tetovës për mbajtjen e ushtrimeve numerike dhe laboratorike në programe të ndryshme studimore.

Në vitin 2018 është zgjedhur asistent doktorant në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore në Tetovë, programin studimor Fizikë, e angazhuar për mbajtjen e ushtrimeve numerike dhe laboratorike me studentët në programe të ndryshme studimore në këto lëndë:

- Biofizika (ushtrime laboratorik dhe ushtrime numerike) në programin studimor Farmaci
- Fizika (ushtrime laboratorik dhe ushtrime numerike) në programin studimor Teknologji Ushqimore dhe Të Ushqyerit në FTU.
- Fizika e mjedisit jetësor në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Statistika dhe bazat e matjeve në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Spektroskopi në programin studimor Fizikë dhe Fizikë-Kimi në FSHMN.
- Elektroteknika në programin studimor Fizikë - FSHMN.
- Fizikë në programin studimor Biologji – FSHMN.
- Biofizikë (ushtrime laboratorike) në programin studimor Fizioterapi të FSHM.
- Fizika në programin studimor Kimi – FSHMN.
- Fizika në programin studimor Matematike– FSHMN.
- Fizikë mjekësore në programin studimor Mjekësi e përgjithshme të FSHM.
- Eksperimente demonstruese nga fizika 1 programin studimor– FSHMN.
- Eksperimente demonstruese nga fizika 2 programin studimor– FSHMN.
- Metodika e mësimdhënies së fizikës 1 programin studimor– FSHMN.
- Metodika e mësimdhënies së fizikës 1 programin studimor– FSHMN.
- Organizimi i punës praktike– FSHMN.
- Biofizikë në Stomatologji programin studimor të FSHM.

Kandidatja për qëllime profesionale në mënyrë aktive shërbehet me gjuhët e huaja angleze dhe sllave.

B. Libra të botuar

Përveç ligjëratave dhe punës me studentë, kandidati ka botuar libra, dispensa, praktikume nga fizika edhe atë:

- **Mirjeta Arifi**, Formulimi bashkëkohor i modelit standard, ArberiaDesign, 2019, ISBN 978-608-236-247-2, Tetove, 2019.
- Burhanedin Neziri, **Mirjeta Mediji**, Fizika për vitin e parë të shkollave të mesme profesionale (Dispensë), Tetove 2009;

- Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e parë, Tetovë 2009;
- Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e dytë, Tetovë 2010;
- Burhanedin Neziri, **Mirjeta Arifi**, Fletore pune për fizikë për sholla të mesme profesionale për vitin e tretë, Tetovë 2010

C. Përshtatje dhe adaptime të librave shkollor

- Cambridge Checkpoint Science Workbook 8 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Fizika 8, tekst pune dhe material didaktik shtese ISBN 978-608-236-396-7, Botues i versionit ne gjuhen shqipe: Arberia Design, Tetove Gusht, 2022.)
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 8 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Fizika 8, tekst pune dhe material didaktik shtese ISBN 978-608-236-348-6, Botues i versionit ne gjuhen shqipe: Arberia Design, Tetove Gusht, 2020.
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 8 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Физика 8, придружен дидактички и работен материјал ISBN 978-608-236-397-4, Botues i versionit ne gjuhen maqedone: Arberia Design, Tetove Gusht, 2022.
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 8 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Физика 8, придружен дидактички и работен материјал ISBN 978-608-236-343-1, Botues i versionit ne gjuhen maqedone: Arberia Design, Tetove Gusht, 2020.
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 9 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Fizika 9, tekst pune dhe material didaktik shtese ISBN 978-608-236-409-4,, Botues i versionit ne gjuhen shqipe: Arberia Design, Tetove Gusht, 2022.)
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 9 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Fizika 9, tekst pune dhe material didaktik shtese ISBN 978-608-236-349-3, Botues i versionit ne gjuhen shqipe: Arberia Design, Tetove Gusht, 2020.
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 9 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Физика 9, придружен дидактички и работен материјал ISBN 978-608-236-410-0, Botues i versionit ne gjuhen maqedone: Arberia Design, Tetove Gusht, 2022.
- Cambridge Checkpoint Science Workbook 9 (Physics) Meri Xhons, Dajan Felous-Friman dhe Dejvid Seng Физика 9, придружен дидактички и работен материјал ISBN 978-608-236-344-8, Botues i versionit ne gjuhen maqedone: Arberia Design, Tetove Gusht, 2020.

D. Redaktive profesionale

- Burhanedin Neziri, Fizika për vitin e dytë të shkollave të mesme të mjekësisë, Tetovë 2008

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Krahas angazhimit në procesin mësimor, kandidatja është marrë vazhdimisht me hulumtime shkencore në fushën e fizikës dhe biofizikës si dhe në fushën e edukimit dhe arsimimit. Veprimtaria e kandidatës përbëhet nga pjesëmarrja në konferenca shkencore, qëndrime shkencore profesionale dhe trajnime të ndryshme profesionale.

A. Punime shkencore

- Mediji Arifi M, Gershan V, Analysis of parameters protocols in computer tomography of the abdomen. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT ISSN 2545-4072 (Print) ISSN 2671-3039 (Online) UDC: 5 *Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 5, No. 9-10, 2020* UDC: 616.3/.4-073.756.8:004]:539.166.074 *Original scientific paper*
- Mediji M, *Contemporary formulation of SM, UNIVERSI-International Journal of Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment* (ISSN: 1857-9450) Volume 05-Issue 01, December 2018

B. Pjesëmarrja në Konferenca

- Xhevahire Hajdari, Mirjeta Mediji Arifi, Fadil Ajredini, *PRIMARY EDUCATION STUDENT'S KNOWLEDGE AND UNDERSTANDING THE MOST IMPORTANT CONCEPTS RELATED TO PHYSICAL QUANTITIES AND UNITS IN REPUBLIC OF KOSOVO*, 2nd International Conference of Natural Sciences and Mathematics – Tetovë, 22-23 Qershor 2018.

IV. VEPRIMTARIA NGA INTERESI MË I GJERË

Gjatë angazhimit si part-time në Universitetin e Tetovës nga viti 2010 deri 2018 si dhe gjatë angazhimit si asistente e rregullt nga viti 2018 deri 2023, kandidatja ka marrë pjesë në organizimin e aktiviteteve Ditët e Hapura në Universitetin e Tetovës në prezantimin e programit studimor Fizikës. Gjithashtu kandidatja ka qenë e angazhuar në promovimin e Universitetit të Tetovës në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kandidati ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme profesionale si:

- Interethnic Integration in Education Project – Projekt i USAID, Tetove, 2016
- Zbatimi i përmbytjeve për risi dhe sipërmarrje ne programin mësimor për arsim në Republikën e Maqedonisë – Projekt i C.E.S, Tetove, 2012
- Aplikimi i metodave dhe teknikave interaktive , Byroja për zhvillimin e arsimit, Tetovë 2016

V. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të pasqyrës së paraqitur më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidatja **Ass. Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi**, në përputhje me Rregulloren e kriterëve dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, nr. 01-4309/2 datë 01. 12. 2021, i plotëson kushtet ligjore dhe profesionale për rizgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **asistent**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidates, Komisioni përfundon se **Ass.Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi** ka kualitet shkencor dhe profesional dhe sipas ligjit për arsim të lartë në Maqedoninë e Veriut dhe në përputhje me rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore dhe mësimore-profesionale në Universitetin e Tetovës i plotëson të gjitha kushtet që të rizgjidhet në thirrjen mësimor-shkencore asistent.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore që kandidaten **Ass. Mr. Sc. Mirjeta Mediji Arifi** ta rizgjedh në thirrjen mësimore-shkencore **ASISTENT** në lëmin **Fizikë, Biofizikë (10300, 10303** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Fizikë të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Dhjetor, 2023

Komisioni recensues:

1. Prof. Dr. Neset IZAIRI (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës

2. Doc. Dr. Kimet JUSUFI (anëtar) - docent në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës,

3. Prof. Dr. Fadil AJREDINI (anëtar) – profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Mirjeta Reshat Mediji Arifi**
(emri, emri i prindit dhe mbiemri)

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Universiteti i Tetovës**
(emri i fakulteti/institucionit)

Fusha shkencore: **Fizikë, Biofizikë (10300, 10303** nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TUTULL BASHKËPUNËTOR-ASISTENT

| Nr. rendor | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|------------|---|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titull shkencor – Magjistër i shkencave nga fusha shkencore për të cilën zgjidhet. Emri i sferës shkencore: Shkencat Matematike-Natyrore Fusha: Fizikë | Po |
| 3 | Zgjedhja e mëparshme në titullin mësimit-shkencor-asistent, data dhe numri i Buletinit: 28. 08. 2018, Nr. 132 | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Universiteti „Shën Kirili dhe Metodi“ Fakulteti Filologjik 4. Data e dhënies së dokumentit: 14. 09. 2017 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË ASISTENTI PËR LËMINË SHKENCORE MATEMATIKË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.82/2018” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.178/2021”), nenit 32, 34, 35 dhe 36, Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, në lidhje me Konkursin për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëminë Matematika, Të tjera (10900, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më 18.11.2023 në gazetata ditore „Koha”, „Slloboda Peçat” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor- Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, solli Vendim me nr.15-2196/1 të datës 30.11.2023, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

1. Prof.Dr. Alit Ibraimi – Kryetar
2. Doc.Dr. Emin Durmishi – Anëtar
3. Prof.Dr. Flamure Sadiki– Anëtar

Në konkurs u paraqit vetëm Mr.Sc. Mirlinda Shaqiri.

Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatja në fjalë, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

RAPORT RECENSUES

I. Të dhënat biografike

Mr.Sc. Mirlinda Shaqiri ka lindur më 06.02.1988 në f. Xhepçisht- Tetovë. Shkollimin fillor e ka kryer në shkollën fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” në f. Poroj në vitin 2002. Shkollën e mesme në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë në vitin 2006.

Në vitin 2006 regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës ku dhe në vitin 2010 i mbaron studimet me notë mesatare 9,17 duke fituar titullin Profesor i diplomuar i Matematikës. Si studente e dalluar, me notë mesatare të lartë, fiton bursë studentore që nga viti i dytë.

Pas përfundimit të studimeve deridiplomike, kandidatja Mr.Sc. Mirlinda Shaqiri në vitin 2012 fillon studimet e Magjistraturës në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës, në programin studimorë Matematikë. Në vitin 2019 Kandidatja mbron me sukses temën me titull “Interpretimet e dizajneve me anë të grupeve” nën mentorimin e Doc.Dr. Flamure Sadiki, duke fituar gradën shkencore Magjistër i Matematikës. Në vitin 2022 kandidatja regjistron studimet e ciklit të tretë në Universitetin „Sv.Kliment Ohrdiski”, në Shkup, në Fakultetin Pedagogjik, fusha e Shkencave Matematike-Natyrore.

II. PËRVOJA PROFESIONALE

Pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve, në vitin 2011 Mirlinda Shaqiri angazhohet si asistente në Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore, programi studimorë Matematikë pranë Universitetit Shtetëror të Tetovës. Po në këtë vit fillon me punë si arsimtare e Matematikës në shkollën fillore “Bratstvo Migjeni”-Tetovë. Në periudhën 2012-2013 kandidatja angazhohet si arsimtare e Matematikës në shkollën fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu”- f. Poroj. Në vitin 2013 vazhdon përvojën profesionale për dy vite shkollore si profesoreshë e Matematikës në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç”-Tetovë. Që nga viti 2015 deri në vitin 2020 kandidatja angazhohet si profesoreshë e Matematikës në Gjimnazin “7 Marsi”-Tetovë. Në vitin 2020 në dhjetor pranohet si asistente në Degën e Matematikës pranë Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Gjuha shqipe është gjuhë amtare, mirëpo flet rrjedhshëm dhe gjuhën maqedone dhe atë angleze. Ka aftësi të mira në sferën e Teknologjisë Informatike, ajo njih dhe shfrytëzon programe të tilla si Microsoft Office dhe SPSS. Në vitin 2023 kandidatja ka marr pjesë në aktivitetin promovues në kaudër të fakultetit „Zgjidhja e testit të maturës me softuer aplikativ”.

Mirlinda Shaqiri është pjesëmarrëse në Konferencën e katër dhe të pestë, të organizuar nga Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës, në vitet 2022, 2023, përkatësisht, si dhe Konferencën e katër të organizuar nga Fakulteti Pedagogjik, Universiteti i Tetovës, viti 2023.

III. VEPRIMTARIA EDUKATIVE-ARSIMORE

Kandidatja veprimtarinë edukative-arsimore e realizon nëpërmjet mbajtjes së ushtrimeve në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në ciklin e parë të studimeve në Programin studimor Matematikë në lëndët Algjebër vektoriale, Gjeometri analitike, Matematikë diskrete, Matematikë numerike, Probabilitet, Bazat e statistikës, Matematikë elementare me praktikum, Programi studimor Matematikë, drejtimi Matematikë financiare në lëndën Proceset stokastike, Programi studimor Informatikë në lëndën Probabilitet dhe Statistikë, Programin studimor Kimi në lëndët Matematikë I dhe Matematikë II, Programi studimor Biologji, drejtimi Biokimi në lëndën Matematikë, Programi studimor Ekologji në lëndën Matematikë, Fakulteti Pedagogjik drejtimi Parashkollor në lëndë Matematikë, në Fakultetin e Shkencave të Zbatuara Programi studimor Ndërtimtari në lëndët Matematikë 1 dhe Matematikë 2, Programi studimor Mekatronikë në lëndët Matematikë 1 dhe Matematikë 2, Programi studimor Inxhinieria e Komunikacionit dhe Transportit në lëndët Matematikë 2 si dhe Probabiliteti dhe modelimi statistikor, Programi studimor Gjeodezi në lëndën Matematika 2, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit, Programi studimor Teknologji ushqimore në lëndën Matematika 1, Programi studimor Nutricion në lëndën Matematika për nutricionistë, Programi studimor Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë ushqimore në lëndën Matematika për shkencat e ushqimit, Fakulteti Ekonomik drejtimi Financa dhe Kontabilitet në lëndën Matematika për ekonomist. Poashtu, ka ligjëruar në lëndën Matematika 1 Programi studimor Ndërtimtari si dhe lëndën Matematika 2 Programi studimor Inxhinieria e Komunikacionit dhe Transportit.

Përpos ushtrimeve, kandidatja realizon edhe konsultime me studentët në lëndët përkatëse të studimeve deridiplomike.

IV. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Përveç angazhimit të rregullt në procesin mësimor, kandidatja Mirlinda Shaqiri në vazhdimësi është angazhuar në veprimtarinë kërkimore-shkencore në fushën e Matematikës.

IV.1. Punime shkencore

1. **Mirlinda Shaqiri**, Lazim Kamberi, Merita Bajrami, (2021) *Comparing student success before and during the pandemic*, JNSM of UT, Vol.6, No.11-12, ISSN 2545-4072 (Print), pg.135-139
2. **Mirlinda Shaqiri**, Lazim Kamberi, Merita Bajrami, Besim Berisha, (2022) *Implementations of first-order differential equations*, JNSM of UT, Vol.7, No.13-14, ISSN 2545-4072 (Print), UDC: 517.952-7, pg.143-145
3. **Mirlinda Shaqiri**, Lazim Kamberi, Merita Bajrami (2022) *Using Euler's method to approach the solution of a first-order differential equations*, JNSM of UT, Vol.7, No.13-14, ISSN 2545-4072 (Print), UDC: 517.912:517.581, pg.140-142
4. Merita Azemi Bajrami, Rushadije Ramani Halili, **Mirlinda Shaqiri**, (2022) *Some properties of semigroup presentations*, JNSM of UT, Vol.7, No.13-14, ISSN 2545-4072 (Print), UDC: 512.53, pg.146-150
5. Lazim Kamberi, Senad Orhani, **Mirlinda Shaqiri**, Sejhan Idrizi, (2022) *Comparison of Three-Parameter Weibull Distribution Parameter Estimators with the Maximum Likelihood Method*, Sakarya University Journal of Science, Vol.26, Issue 6, ISSN 1301-4048 e-ISSN 2147-835X, DOI: 10.16984, pg.1084-1092
6. **Mirlinda Shaqiri**, Teuta Iljazi, Lazim Kamberi, Rushadije Ramani Halili, (2023) *Differences between the correlation coefficient Pearson, Kendall and Spearman*, JNSM of UT, Vol.8, No.15-16, ISSN 2545-4072 (Print) UDC: 519.235/.237, pg.392-397
7. Merita Azemi Bajrami, Rushadije Ramani Halili, **Mirlinda Shaqiri**, (2023) *Some computations of numerical semigroups with embedding dimension 3 on GAP*, JNSM of UT, Vol.8, No.15-16

IV.2. Pjesëmarrja në konferenca:

1. **Mirlinda Shaqiri**, Lazim Kamberi, Merita Bajrami, Besim Berisha, (2022) *Implementations of first-order differential equations*, Fourth International Conference of Natural Sciences and Mathematics, (ICNSM 22)
2. **Mirlinda Shaqiri**, Lazim Kamberi, Merita Bajrami (2022) *Using Euler's method to approach the solution of a first-order differential equations*, Fourth International Conference of Natural Sciences and Mathematics, (ICNSM 22)
3. Merita Azemi Bajrami, Rushadije Ramani Halili, **Mirlinda Shaqiri**, (2022) *Some properties of semigroup presentations*, Fourth International Conference of Natural Sciences and Mathematics, (ICNSM 22)
4. **Mirlinda Shaqiri**, Teuta Iljazi, Lazim Kamberi, Rushadije Ramani Halili, (2023), *Differences between the correlation coefficient Pearson, Kendall and Spearman*, Fifth International Conference of Natural Sciences and Mathematics, (ICNSM 23)
5. Merita Azemi Bajrami, Rushadije Ramani Halili, **Mirlinda Shaqiri**, (2023) *Some computations of numerical semigroups with embedding dimension 3 on GAP*, Fifth International Conference of Natural Sciences and Mathematics, (ICNSM 23)
6. **Mirlinda Shaqiri**, Teuta Iljazi, *Problem tasks in mathematics textbooks* (2023), Fourth International Scientific Conference of the Faculty of Pedagogy, (ISCFPE 23)

V. PËRFUNDIM DHE PROPOZIM

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në konkursin e shpallur për zgjedhjen/rizgjedhjen e një asistenti për lëndët mësimore në fushën e Matematikës, kandidatja i plotëson kushtet ligjore dhe profesionale sipas nenit 173 të Ligjit për arsimin e lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.82/2018” dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr.178/2021”).

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm të punës arsimore, kërkimore-shkencore, publikimin e punimeve shkencore e profesionale dhe referimet në konferencat ndërkombëtare si dhe përvojës në punën arsimore, Komisioni Recensues konstaton se Mr.Sc. Mirlinda Shaqiri i plotëson të gjitha kushtet për t’u zgjedhur në thirrjen që ka konkuruar. Andaj Komisioni Recensues ka nderin që t’i propozojë Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, që kandidatja Mr.Sc. Mirlinda Shaqiri të rizgjidhet **ASISTENT** për lëndët mësimore në fushat shkencore Matematika, Të tjera (10900, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjëve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Tetovë, Dhjetor, 2023

KOMISIONI RECENSUES:

1. Prof. Dr. Alit Ibraimi - Kryetar

2. Doc.Dr. Emin Durmishi - Anëtar

3. Prof. Dr. Flamure Sadiki - Anëtar

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË,
SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Mirlinda Selam Shaqiri**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Matematika, Të tjera (10900, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR - ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Matematikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,17 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 8,11 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2022 | Po |

R E F E R A T

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË DY ASISTENTËVE NË LËMIN E INFORMATIKËS, SISTEMET E INFORMACIONIT DHE PROGRAMIMI, PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MATEMATIKE – NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/18), nenit 32, 34, 35 dhe 36 Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, në lidhje me Konkursin për zgjedhje/rizgjedhje të dy asistentëve në lëmin e Informatikës, Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **18. 11. 2023** në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit Filologjik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. XI. 2023**, solli Vendim me nr. **15-2193/1** të datës **30. XI. 2023**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florim IDRIZI** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 2. Prof. Dr. Florinda Imeri** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,
- 3. Prof. Dr. Valbon Ademi** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

R A P O R T

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të dy asistentë në lëmin e Informatikës, Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në afatin e paraparë janë paraqitur dy kandidatë:

- I. Asst. Mr. Nexhibe Sejfuli – Ramadani**
- II. Asst. Mr. Verda Misimi Jonuzi**

I. Kandidatja Asst. Mr. Nexhibe Sejfuli – Ramadani

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Nexhibe Sejfuli – Ramadani u lind më 04.12.1990 në Tetovë. Nga viti 2018 ajo vazhdon studimet në ciklin e tretë në Universitetin “Kirili dhe Metodij” në Shkup, në Fakultetin e Elektroteknikës dhe Teknologjisë Informative në drejtimin Elektroteknikë dhe Teknologji Informative në fushën e Cyber Security.

Studimet e ciklit të dytë i kreu me datë 25.01.2016 në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore, në Programin e Informatikës, me tezë “Analiza, modifikimi dhe krahasimi i sensorëve që përdoren te pajisjet mobile” dhe me notë mesatare 9.56, edhe fitoi titullin **Magjistër i Informatikës**, me 60 kredi të fituara.

Studimet universitare i kreu më 16.09.2013 në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor të Informatikës, me temë diplome “Sistemi Online për menaxhim hotelarik” ku fiton titullin **Inxhinier i diplomuar i informatikës**, me 240 kredi të fituara dhe me notë mesatare 9.72.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, nga viti 2013 angazhohet si asistente part-time në Programin studimor të Informatikës.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Kandidatja Nexhibe Sejfuli – Ramadani ka qenë anëtare e komisionit organizativ në “2nd International Conference of Natural Science and Mathematics” në Universitetin e Tetovës, Prill 2018 – Qershor 2018 dhe “3rd International Conference of Natural Science and Mathematics” në Universitetin e Tetovës, Prill 2019 – Maj 2019.

Pjesëmarrëse në realizimin e aktivitetit, Ditët e hapura të UT, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore, 2017/2023 dhe pjesëmarrëse në realizimin e aktivitetit, Ditët e hapura të UT, Fakulteti i Shkencave Matematike – Natyrore, 2018/2023

Gjithashtu gjatë periudhës Janar 2020 – Mars 2020, ka qenë pjesë e projektit Research in the NATO Science for Peace Multi-Year Project SPS G5633, ANTI-DRONES – Innovative concept to Detect, Recognize and Track “Killer Drones”.

Nexhibe Sejfuli – Ramadani në periudhën 17-18 Shtator 2020 në Shkup do merr pjesë në “Avancimi i kompetencave të mësimdhënësve për mësim ONLINE”

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë fletë rrjedhshëm edhe gjuhën maqedonase dhe gjuhën angleze. Ka njohuri në dizajnimin dhe implementimin e bazave të të dhënave (SQL Server, MySQL, MS Access), ka aftësi të mira në sferën e programimit, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, Python, njohuri të mira në HTML, CSS, Java Script, Wordpress dhe përpunim multimedial. Gjithashtu njohje të mirë të sistemit operativ LINUX, paketës Office.

Nga viti 2013- 2023 angazhohet si asistente në lëndët: Bazat e të dhënave, FSHMN, drejtimi Informatikë; Qarqe Logjike I, FSHMN, drejtimi Informatikë; Programim në C++, FSHMN, drejtimi Matematikë; Interneti, FSHMN, drejtimi Informatikë; Ueb Dizajn, Fakulteti Juridik, drejtimi Gazetari; Sisteme Multimediale, FSHMN, drejtimi Informatikë; Statistikë Mjekësore me Informatikë, FSHM, drejtimi Infermieri; Statistikë Mjekësore me Informatikë, FSHM, drejtimi Mjekësi e Përgjithshme; Informatika për Psikologët, Fakulteti Filozofik, drejtimi Psikologji; Teknologji Informative, Fakulteti i Administrimit të Biznesi, drejtimi Administratë Biznesi.

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:

a) *Rezultatet shkencore të kandidatit që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:*

Kandidatja Asst. Mr. Nexhibe Sejfuli - Ramadani në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore njihet me disa punime shkencore të cilat rrjedhin si rezultat i kërkimeve shkencore gjatë periudhës së përgatitjes të punimit të diplomës, magjistraturës dhe doktoratës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës Nexhibe Sejfuli - Ramadani, fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës me titull: “Sistemi Online për menaxhim hotelierik” në Fakultetin e Shkencave Matematike -Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 16. 09. 2013. Veprimtaria e saj në fushën e Shkencave Kompjuterike vazhdon me punimin e magjistraturës me titull: „Analiza, modifikimi dhe krahasimi i sensorëve që përdoren te pajisjet mobile“ mbrojtur në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 25. 01. 2016.

b) *Pasqyra e konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:*

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. **Sejfuli, Nexhibe;** Idrizi, Florim; Ramadani, Erenis (2016). ANALYSIS AND COMPARISON OF SENSORS USED IN MOBILE DEVICE. International Journal on Information Technologies and Security, No. 1 (vol. 8) ISSN: 1313-8251.
2. **Sejfuli – Ramadani, Nexhibe;** Misimi, Verda; Ramadani, Erenis; Idrizi, Florim (2016). THE ROLE AND THE IMPACT OF DIGITAL CERTIFICATE AND DIGITAL SIGNATURE IN IMPROVING SECURITY DURING DATA TRANSMISSION. International Conference On Sustainable Development 19 – 23 October 2016 Skopje
3. Misimi, Verda; **Sejfuli-Ramadani, Nexhibe;** Ramadani, Erenis (2017). THE EVOLUTION OF E-COMMERCE WITH USE OF MOBILE DEVICES. 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics – ICNSM JUNE 16, 2017, Tetova, Macedonia.
4. Ramadani, Erenis; Memeti, Agon; Imeri, Florinda; **Sejfuli-Ramadani, Nexhibe** (2017). SOCIAL MEDIA BASED APP ORGANIZING DAILY EVENTS. 6th Mediterranean Conference on Embedded Computing – MECO, JUNE 11 – 15, 2017; Bar, Montenegro ISBN: 978-1-5090-6742-8.
5. **Sejfuli-Ramadani, Nexhibe;** Idrizi, Florim; Misimi, Verda; Ramadani, Erenis (2018) BLOCKCHAIN: GENERAL OVERVIEW OF THE ARCHITECTURE, SECURITY AND RELIABILITY. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 3 (5-6). pp. 64-68. ISSN 2671-3039
6. **Sejfuli - Ramadani, Nexhibe** and Idrizi, Florim and Imeri, Florinda (2019) THE INFLUENCE OF THE DARK WEB. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4 (7-8). pp. 95-98. ISSN 2671-3039

7. Imeri, Florinda; Memeti, Agon, **Sejfuli-Ramadani , Nexhibe**; Saliu, Hana (2019) THE IMPACT OF PPT PRESENTATION IN TEACHING AND LEARNING PROCESS CASE STUDY: UNIVERSITY OF TETOVA. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4 No. 7-8. pp. 72-76. ISSN 2671-3039
8. Shemshi, Vjollca and Idrizi, Florim and Idrizi, Hirijete and **Sejfuli-Ramadani, Nexhibe** (2022) VERIFICATION OF ELECTRONIC IDENTITY IN FEDERATED SYSTEMS USING MULTI-FACTOR AUTHENTICATION. Journal of Applied Sciences-SUT, 8 (15-16). pp. 241-245. ISSN 2671-3047
9. **Sejfuli-Ramadani, Nexhibe**; Risteski, Aleksandar; Idrizi, Florim; Shemshi, Vjollca (2021) REVIEWING THE LATEST TRENDS OF IMPLEMENTING BLOCKCHAIN TECHNOLOGY SOLUTIONS IN SEVERAL BUSINESS-RELATED INDUSTRIES. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 6 (11-12). pp. 60-69. ISSN 2671-3039
10. RADONIQA KUSARI, Yllka; **SEJFULI – RAMADANI ,Nexhibe**; IDRIZI ,Florim; RISTESKI, Aleksandar (2022) CHALLENGES OF DISTANCE EDUCATION DURING THE COVID-19 PANDEMIC IN PROFESSIONAL HIGH SCHOOL. International Congress On Natural, Health Sciences and Technology, 18 – 19 May, 2022 Tetova, Republic of North Macedonia ISBN: 978-608-217-101-2
11. IDRIZI, Florim; **SEJFULI-RAMADANI, Nexhibe**; ISMAILI, Shpend; SHEMSHI, Vjollca (2022) APPLICATION OF CRYPTOGRAPHY IN M-BANKING. 4th International Conference of Natural Sciences and Mathematics, 18-19 May, 2022 Tetova, Republic of North Macedonia, ISBN: 978-608-217-101-2
12. **SEJFULI-RAMADANI, Nexhibe**; POPOVSKI, Borislav; RISTESKI, Aleksandar (2023) INTEGRATION AND IMPLEMENTATION OF BLOCKCHAIN TECHNOLOGIES IN THE AUTOMOTIVE INDUSTRY. Journal of Natural Sciences and Mathematics, Vol. 8, No. 15-16, 2023. pp.(283-291) ISSN: 2545-4072 (Print), ISSN: 2671-3039 (Online)
13. BAHTIRI, Yllka; BYTYCI, Enkelejda; IDRIZI, Florim; ISMAILI, Shpend; **SEJFULI-RAMADANI, Nexhibe** (2023) CYBER SECURITY IN EDUCATIONAL INSTITUTIONS. Journal of Natural Sciences and Mathematics, Vol. 8, No. 15-16, 2023. pp.(307-314). ISSN: 2545-4072 (Print), ISSN: 2671-3039 (Online)

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje në II. International Conference on Sustainable Development, **19-23 Tetor 2016**.
2. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Konferencën e parë Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **Qershor 2017**.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrje në 6th Mediteranean Conference on Embedded Computing in Bar, Montenegro, **11-15 Qershor 2017**.
4. **Certifikatë** për prezantim në Konferencën e dytë Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **22-23 Qershor 2018**.
5. **Certifikatë** për pjesëmarrje në seminarin në temën: AVANCIMI I KOMPETENCAVE TË MËSIMDHËNËSVE PËR MËSIMIN ONLINE, i cili u mbajtë në hapësirat e Universitetit Nënë Tereza, Shkup, **17-18 Shtator 2020**.
6. **Certifikatë** për realizim të trajnimit online me temë: Basic rules of Cyber Hygiene, **26 Tetor 2021**.
7. **Certifikatë** për prezantim në Konferencën e katërt Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **18-19 Maj 2022**.

8. **Mirënjohje** për kontribut, bashkëpunim dhe mbështetje në aktivitetet promovuese të Universitetit të Tetovës për vitin akademik 2023/24, **18 Prill 2023**.

9. **Certifikatë** participimi në Konferencën e katërt Ndërkombëtare në Inxhinieri dhe Shkencat e Aplikuara Natyrore në Konya/Turkey, **20-21 Nëntor 2023**.

4. Veprimtaria profesionale-aplikative:

4.1. Libër nga fusha profesionale

1. Florim Idrizi, Florinda Imeri, Agon Memeti, **Nexhibe Sejfuli – Ramadani**, Vjollca Shemshi, Verda Misimi: “QARQE LOGJIKE”, Tetovë, 2023. ISBN 978-608-217-116-6.

4.2. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

- Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Informatikë **2014 – 2023**.

- Anëtare e komisionit organizativ në International Conference of Natural Science and Mathematics në Universitetin e Tetovës, **2018-2023**.

- Trajnim njëditor me nxënësit e shkollave të mesme, me temë: Krijimi i një uebfaqje duke përdorur platformën Wordpress, **Maj, 2023**.

- Pjesëmarrje në aktivitetet promovuese të Universitetit të Tetovës, për vitin akademik **2023/24**.

4.3. Pjesëmarrje në projekte

- Pjesë e projektit Research in the NATO Science for Peace Multi-Year Project SPS G5633, ANTI-DRONES – Innovative concept to Detect, Recognize and Track “Killer Drones”. **Janar 2020 – Mars 2020**.

II. Kandidatja Asst. Mr. Verda Misimi Jonuzi

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Verda Misimi Jonuzi u lind në 08.01.1992 në Tetovë. Shkollën fillore e kreu në SH.F. “Abdyl Frashëri” në Bogovinë, në periudhën 1999-2007, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjymnazi “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë gjatë periudhës 2007-2011. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Informatikës në periudhën 2011-2015, ku fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës, me notë mesatare **9.03**.

Verda Misimi Jonuzi si studente e dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore e ofruar nga MASH që nga viti i dytë i studimeve deri në përfundimin e studimeve.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistente part-time në Programin studimor Informatikës. Prej vitit 2015 ajo vazhdon si asistente part-time në Universitetin e Tetovës, në katedrën e Informatikës.

Më Nëntor 2018, Verda Misimi Jonuzi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare **9.91**, me temë të magjistraturës “Aplikimi i Internet of Things për sistemet e automatizimit Smart Home duke përdorur Raspberry Pi”, dhe fiton titullin **Magjistër i Informatikës**.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodij”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike, në drejtimin Shkenca dhe Inxhinieri Kompjuterike, ku vazhdon hulumtimet në sferën e Internet of Things dhe Smart City.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Verda Misimi Jonuzi në vitin 2016 merr pjesë në eventin e organizuar nga Universiteti i Tetovës dhe kompania Google, të quajtur “Google Your Future: Hackathon” në datë 25.02.2016, ku do të fitoj Vendin e Parë, dhe do të shpërblehet me certifikatë nga Rektori i Universitetit të Tetovës dhe përfaqësuesja e Google, Margaret Fortney.

Gjithashtu kandidates Verda Misimi Jonuzi në 3 Mars 2016 (dita e Komunës së Tetovës) i ndahet Mirënjohje për kontributin e veçantë në promovimin e vlerave moderne në fushën e shkencës, nga kryetarja e komunes zonja Teuta Arifi.

Ka aftësi të mira në sferën e programimit, ku ndër të tjera mund të theksohen, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, njohuri të mira në HTML, CSS, Prolog, WordPress, Bootstrap dhe përpunim multimedial.

Ka njohuri edhe në dizajnimin dhe implementimin e databazave (SQL Server dhe MySQL), njohje të mirë të sistemit operativ LINUX. Poashtu kandidatja posedon njohuri edhe në Matlab, Javascript, Arduino njohje të mirë të inxhinierisë softuerike, veçanërisht në dizajnimin e metodave më efikase dhe efektive për modelim të sistemeve kompjuterike etj.

Verda Misimi Jonuzi në periudhën prej 24.12.2013 deri më 27.01.2014 ka realizuar praktikë profesionale në Qendrën për Arsim Profesional dhe Trajnim, për të cilën më pastaj do të shpërblehet me vërtetim për praktikë të kryer.

Ka qenë edhe pjesë e trajnimeve të ndryshme, ndër të cilat do të përmendim pjesëmarrjen në Microsoft Youthspark eventin, në periudhën 21-22 Maj 2014.

Nga viti 2015- 2023 angazhohet si asistente në lëndët: Inxhinieri Softuerike, FSHMN, drejtimi Informatikë; Inteligjenca artificiale, FSHMN, drejtimi Informatikë; Sistemet bashkëkohore FSHMN, drejtimi Informatike; Statistikë mjekësore dhe informatikë, FSHM, drejtimi Mjekësi e Përgjithshme; Informatika II, Fakulteti Filologjik, drejtimi Gjuhë dhe letërsi Gjermane; Informatika I, Fakulteti Filologjik, drejtimi Gjuhë dhe letërsi angleze; Bazat e informatikës, Fakulteti i Arteve, drejtimi Dizajn Grafik; e-Biznes, FSHMN, drejtimi Informatikë; Informatika, FSHMN, Biokimi; Informatika, FSHMN, Biologji Arsimore; Analiza dhe dizajni i sistemeve të informacionit, FSHMN, drejtimi Informatika në Biznes; Arkitektura e kompjuterëve, FSHMN, drejtimi Informatikë; Tregtia elektronike, FSHMN, drejtimi Informatikë Biznesi; Zhvillimi i sistemeve interaktive, FSHMN, drejtimi Informatikë; Hyrje në informatikë; FSHMN, drejtimi Kimi; Hyrje në informatikë; FSHMN, drejtimi Biokimi Analitike.

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:

a) Rezultatet shkencore të kandidates që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:

Kandidatja Ass. Mr. Verda Misimi Jonuzi në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore njihet me disa punime shkencore të cilat rrjedhin si rezultat i kërkimeve shkencore gjatë periudhës së përgatitjes të punimit të diplomës, magjistraturës dhe doktoratës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës Verda Misimi Jonuzi, fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës me titull: „ Adaptimi i platformës për mësim online në shkollat fillore “ në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 25.09. 2015. Veprimtaria e saj në fushën e Informatikës vazhdon me punimin e magjistraturës me titull: “Aplikimi i Internet of Things për sistemet e automatizimit Smart Home duke përdorur Raspberry Pi” mbrojtur në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi studimor Informatikë, më 28. 05. 2018.

b) Pasqyra e konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. Sejfuli – Ramadani, Nexhibe; **Misimi, Verda**; Ramadani, Erenis; Idrizi, Florim (2016). THE ROLE AND THE IMPACT OF DIGITAL CERTIFICATE AND DIGITAL SIGNATURE IN IMPROVING SECURITY DURING DATA TRANSMISSION. International Conference On Sustainable Development 19 – 23 October 2016 Skopje
2. **Misimi, Verda**; Sejfuli-Ramadani, Nexhibe; Ramadani, Erenis (2017). THE EVOLUTION OF E-COMMERCE WITH USE OF MOBILE DEVICES. 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics – ICNSM JUNE 16, 2017, Tetova, Macedonia
3. Sejfuli-Ramadani, Nexhibe; Idrizi, Florim; **Misimi, Verda**; Ramadani, Erenis (2018) BLOCKCHAIN: GENERAL OVERVIEW OF THE ARCHITECTURE, SECURITY AND RELIABILITY. Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 3 (5-6). pp. 64-68. ISSN 2671-3039
4. **Misimi Jonuzi, Verda**;, Xhaferi, Miranda; Seferi, Ylldrita; Sejfuli-Ramadani, Nexhibe;(2023)APPLICATION OF IOT IN THE DEVELOPMENT OF HOME AUTOMATION SYSTEMS, 4 th International Conference on Engineering and Applied Natural Sciences, November 2023 Konya, Turkey
5. Halili,Festim; **Misimi, Verda**; Iseni,Rilinda; Salihi, Mirije; (2018) MOBILE CLOUD COMPUTING: A NEW WAY OF CLOUD COMPUTING, UBT 6th Annual International Conference, OCTOBER 27-29, 2017, Durres, Albania
6. **Misimi, Verda**; Xhaferi, Miranda; (2018) A SURVEY: INTERNET OF THINGS (IOT) - APPLICATIONS, BENEFITS& CHALLENGES; XIX International Scientific Conference KNOWLEDGE IN PRACTICE 14 – 16 DECEMBER, 2018
7. Xhaferi, Miranda; Salihi, Ylldrita; **Misimi, Verda**; (2022)SOLVING INITIAL-VALUE PROBLEM BY COMPARING LAPLACE TRANSFORM AND AN NUMERICAL PREDICTOR-CORRECTOR METHOD; KNOWLEDGE-International Journal . ISSN : 2545-4439
8. Salihi, Ylldrita; Xhaferi, Miranda; Rasimi, Krutan; **Misimi Jonuzi, Verda** (2022) A PREDICTOR-CORRECTOR METHOD FOR SOLVING DIFFERENTIAL EQUATIONS OF FRACTIONAL ORDER Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, 7 (13-14). pp. 158-165. ISSN 2671-3039

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** participimi në Microsoft YouthSpark Live event, **21-22 Maj 2014**.
2. **Certifikatë** për Vendin e I në Google Your Future Hackathon, **25 Shkurt 2016**.
3. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Google Your Future Hackathon, **25 Shkurt 2016**.

4. **Mirënjohje** për kontributin e veçantë në promovimin e vlerave moderne në fushën e shkencës nga Komuna e Tetovës, **03 Mars 2016**.
5. **Certifikatë** për pjesëmarrje në II. International Conference on Sustainable Development, **19-23 Tetor 2016**
6. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në Konferencën e parë Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **Qershor 2017**.
7. **Certifikatë** për prezantim në Konferencën e dytë Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **22-23 Qershor 2018**.
8. **Certifikatë** publikimi në Knowledge International Journal Vol.28, **14 Dhjetor 2018**.
9. **Certifikatë** për realizim të trajnimit online me temë: Basic rules of Cyber Hygiene, **26 Tetor 2021**.
10. **Certifikatë** publikimi në Knowledge International Journal Vol.49, **15 Dhjetor 2021**.
11. **Certifikatë** për prezantim në Konferencën e katërt Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **18-19 Maj 2022**.
12. **Certifikatë** për prezantim në Konferencën e pestë Ndërkombëtare të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, **17-19 Maj 2023**.
13. **Certifikatë** participimi në Konferencën e katërt Ndërkombëtare në Inxhinieri dhe Shkencat e Aplikuara Natyrore në Konya/Turkey, **20-21 Nëntor 2023**.

4. Veprimtaria profesionale-aplikative:

4.1. Libër nga fusha profesionale

1. Florim Idrizi, Florinda Imeri, Agon Memeti, Nexhibe Sejfuli-Ramadani, Vjollca Shemshi, **Verda Misimi:** „Qarqe Logjike“, Tetovë, 2023, ISBN 978-608-217-116-6.

4.3. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

- Ditët e hapura, Universiteti i Tetovës, prezantim i programit studimor Informatikë **2014 – 2023**.
- Trajnim njëditor me nxënësit e shkollave të mesme, me temë: Krijimi i një uebfaqe duke përdorur platformën Wordpress, **Maj, 2023**.

5. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese dhe profesionale-aplikative dhe konstaton se të dy kandidatet **Asst. Mr. Nexhibe Sejfuli – Ramadani dhe Asst. Mr. Verda Misimi Jonuzi** në përputhje me Rregulloren e kritereve dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, nr. **15-2120/1** e datës **29.12.2020**, i plotësojnë kushtet për rizgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **asistent**.

Në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidatit nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidatet **Asst. Mr. Nexhibe Sejfuli – Ramadani dhe Asst. Mr. Verda Misimi Jonuzi** të rizgjedhen në thirrjen mësimore-shkencore **asistent** në lëmin e Informatikës dhe Sistemet e Informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin Informatikë, drejtimi Shkenca Kompjuterike të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, dhjetor 2023

Komisioni recensues:

1. **Prof. Dr. Florim IDRIZI** (kryetar) - profesor ordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,

2. **Prof. Dr. Florinda Imeri** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,

3. **Prof. Dr. Valbon Ademi** (anëtar) - profesor inordinar në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës,

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Nexhibe Qazim Sejfuli Ramadani**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR – ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Informatikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,72 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 9,56 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2022 | Po |

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË, SHKENCORË,
MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Verda Misimi Jonuzi**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Informatikë, Sistemet e informacionit dhe programim (11000, 11002 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR - ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Informatikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,03 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 9,91 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuha e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2022 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE E NJË ASISTENTI NË LËMIN E INFORMATIKËS, ZHVILLIMI I SOFTUERIT DHE BAZAT E TË DHËNAVE PRANË FAKULTETIT TË SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE NË UNIVERSITETIN TË TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsim të lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 82/18), nenit 32, 34, 35 dhe 36 Rregullores për kushtet e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës nr. **01-4309/2** e datës **01. XII. 2021**, në lidhje me konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje e një asistenti në lëmin e Informatikës, Zhvillimi i softuerit dhe bazat e të dhënave (11000, 11010 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), të shpallur më **18. 11. 2023** në gazetata ditore „Koha“ dhe „Sloboden Peçat“, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të shkencave matematike-natyrore të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më **30. XI. 2023**, solli Vendim me nr. **15-2190/1** të datës **30. XI. 2023**, me të cilin formohet Komision recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Florinda Imeri (kryetar)** – profesor inordinar pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës
- 2. Prof. Dr. Agon Memeti (anëtar)** – profesor inordinar pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës
- 3. Doc. Dr. Shpend Ismaili (anëtar)** – docent pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

Si anëtarë të Komisionit recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, sjellim këtë

R A P O R T

Në konkursin e shpallur për zgjedhje/rizgjedhje të një asistenti në lëmin e Informatikës, Zhvillimi i softuerit dhe bazat e të dhënave (11000, 11010 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në afatin e paraparë është paraqitur vetëm kandidatja:

Ass. Mr. Vjollca Shemshi

1. Të dhëna biografike dhe arsimimi:

Vjollca Shemshi u lind në 29.11.1989 në Xhepçisht. Shkollën fillore e kreu në SH.F. “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në Poroj, në periudhën 1996-2004, ndërsa shkollën e mesme e kreu në Sh.M.K. Gjinnazi “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë gjatë periudhës 2004-2008. Studimet universitare i kreu në Universitetin e Tetovës, në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, në Programin studimor Informatikë në periudhën 2008-2012, ku fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës, me notë mesatare 9.15.

Vjollca Shemshi si studente e dalluar me notë mesatare të lartë fiton bursën studentore e ofruar nga MASH që nga viti i dytë i studimeve deri në përfundimin e studimeve.

Më 05 tetor 2013, Vjollca Shemshi mbaron studimet e ciklit të parë në Universitetin e Tetovës, me temë “Visual Basic në Access 2010” dhe fiton titullin Inxhinier i diplomuar i informatikës.

Pas mbarimit të studimeve të ciklit të parë, angazhohet si asistente part-time në Programin studimor Informatikë.

Më 25 qershor 2016, Vjollca Shemshi mbaron studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës me notë mesatare 9.50, me temë të magjistraturës “Disa aspekte praktike dhe aplikative në sistemet për mësim elektronik e-learning, krahasimi ndërmjet sistemeve Blackboard dhe Moodle”, dhe fiton titullin Magjistër i Informatikës.

Aktualisht vijon studimet në ciklin e tretë, në Universitetin “Kirili dhe Metodi”, në Shkup, në Fakultetin e Shkencave Informatike dhe Inxhinierisë Kompjuterike, në drejtimin Informatikë, ku vazhdon hulumtimet në sferën e identifikimit elektronik, rreziqet e mundshme dhe sigurinë e sistemeve elektronike bashkëkohore, mjetet dhe teknologjitë e implementimit si dhe metodat dhe teknikat që përdoren në ditët e sodit për siguri më të lartë të të dhënave.

2. Veprimtaria mësimore-arsimore:

Vjollca Shemshi në periudhën prej nëntor 2014 deri në qershor 2016 ka qenë e angazhuar edhe në Qendrën e Provimeve Shtetërore, si bashkëpunëtor në sektorin e informatikës, dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ka qenë e përfshirë në procesin e provimeve të maturës shtetërore.

Nga muaji shkurt 2020 është angazhuar në Ndërmarrjen Publike, Radiodifuzioni Nacional Shkup, si ndihmës i udhëheqësit, në Sektorin për Zhvillim dhe Hulumtim, në Departamentin e IT-së. Në periudhën që ka qenë e angazhuar në këtë departament, ka realizuar një numër të madh të aktiviteteve, ndër më të rëndësishmet janë: Menaxhimi i stafit në sektorin e IT, zhvillimi dhe mirëmbajtja e të gjitha llojeve të programeve që përdor NRD (kontabiliteti, arkiva, moduli i burimeve njerëzore etj.), anëtare e ekipit të projektit për implementimin e strategjisë kombëtare Broadband në Maqedonia e Veriut, hartëzimi i të gjitha

përdoruesve të mundshëm të institucioneve publike për internet me fibra optik dhe Wi-Fi, zbatimi dhe menaxhimi i platformës Gis (nga ESRI), anëtare e grupit për implementimin e standardeve të cilësisë ISO (9001:2015).

Në mënyrë direkt ka qene e përfshirë në projektin Broadband, ku në qershor 2020 ka marrë edhe trajnime të posaçme për përdorimin e platformës GIS nga kompania Intelligent Network Solution (INS) ku më pas është certifikuar për përfundimin e suksesshëm të trajnimit.

Gjithashtu në tetor 2020 ka qenë pjesë e trajnimit për implementimin e standardeve të cilësisë ISO (9001:2015) ku me sukses përfundoi trajnimin dhe kaloi testin për ISO 9001:2015 Internal Auditor.

Në gusht të vitit 2019, Byroja për Zhvillim e Arsimit në Shkup kandidaten Vjollca Shemshi e angazhoi si instruktore për të realizuar trajnim për të gjithë mësimdhënësit e shkollave fillore në tërë Maqedoninë e Veriut për implementimin e kurrikulës (programit mësimor) nacional të informatikës, si dhe realizimin e një programi mësimor ditor.

Në janar të vitit 2020, Vjollca Shemshi u angazhua si instruktore nga kompania IFES Shkup, për të realizuar trajnim për ndërgjegjësimin e higjienës kibernetike, për të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor të zgjedhjeve të realizuara në korrik të vitit 2020, në tërë Maqedoninë e Veriut, ku si tema kyçe kanë qenë: Mbrojtja e informacionit personal / publik, parandalimi i sulmeve Phishing, siguria e llogarive personale, politika e fjalëkalimeve personale dhe shumë tema të tjera.

Gjuha shqipe është gjuha amtare, megjithatë zotëron edhe gjuhën maqedonase, gjuhën angleze. Ka aftësi të mira në sferën e programimit, ku ndër të tjera mund të theksohen, njohje e mirë e gjuhës programore C# (konsollë, windows dhe web aplikacionet), gjuhët programore C++, PHP, njohuri të mira në HTML, CSS, Wordpress, përpunim multimedial.

Ka njohuri edhe në dizajnimin dhe implementimin e databazave (SQL Server, MySQL), njohje të mirë të sistemit operativ LINUX, paketës Office etj. Poashtu, kandidatja posedon njohuri edhe në Matlab, Javascript, Multisim, GIS (ArcMap , ArcCatalog) njohje të mirë të inxhinierisë softuerike, veçanërisht në dizajnimin e metodave më efikase dhe efektive për modelim të sistemeve kompjuterike etj.

3. Veprimtaria shkencore-hulumtuese:

a) Rezultatet shkencore të kandidatës që janë me rëndësi të veçantë për zgjedhje në thirrje shkencore:

Kandidatja Ass. Mr. Vjollca Shemshi në pikëpamje të veprimtarisë hulumtuese-shkencore njihet me disa punime shkencore të cilat rrjedhin si rezultat i kërkimeve shkencore gjatë periudhës së përgatitjes të punimit të diplomës, magjistraturës dhe doktoratës. Veprimtaria shkencore-hulumtuese e kandidatës Vjollca Shemshi, fillon me përgatitjen dhe mbrojtjen e punimit të diplomës me titull: „ Visual Basic in Access 2010 “ në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës, programi

studimor Informatikë, më 05.10. 2012. Veprimtaria e saj në fushën e Informatikës vazhdon me punimin e magistraturës me titull: “Disa aspekte praktike dhe aplikative në sistemet për mësim elektronik e-learning, krahasimi ndërmjet sistemeve Blackboard dhe Moodle” mbrojtur në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës ,, programi studimor Informatikë, më 25. 06. 2016.

b) Pasqyra e konferencave, seminareve në vend dhe jashtë vendit:

3.1. Punime shkencore të botuara në revista profesionale dhe ndërkombëtare:

1. **Vjollca Ismaili**, Fisnik Dalipi, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “A study on Learners’s Perception of Moodle and Blackboard for Blended Learning in a Macedonian University” 1st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, University of Tetovo, Tetovo
2. **Vjollca Shemshi**, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “Dark Web and its Impact” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 3 | No. 5-6, dhe në 2st International Conference of Natural Sciences and Mathematics, May, 2018, University of Tetovo, Tetovo.
3. **Vjollca Shemshi**, Florim Idrizi, Qebir Shemshi “Risks of Electronik Identity in Education, By using Two Protocols: Openid Connect And Saml Protocols”, Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT, Vol. 4 | No. 7-8, dhe në 3rd International Conference of Natural Sciences and Mathematics, University of Tetovo, Tetovo
4. Nexhibe Sejfuli Ramadani, Florim Idrizi, **Vjollca Shemshi**, Aleksander Ristevski “Reviewing the latest trends of implementing Blockchain Technology solutions in several business-related industries”, Journal of Natural Science and Mathematics, May 2021 (INSM) 6, University of Tetovo, Tetovo
5. **Vjollca Shemshi**, Florim Idrizi, Nexhibe Sejfuli Ramadani “Verification of Electronic Identity in Federated Systems using Multi-Factor Authentication, Journal of Applied Sciences vol-8 | no-15-16-2022, SUT 8 (15-16), 241-245, University of Tetovo, Tetovo
6. Florim Idrizi, Nexhibe Sejfuli Ramadani, Shpend Ismaili, **Vjollca Shemshi** “Application of Cryptography in M-Banking”, Journal of Natural Sciences and Mathematics, 2022, University of Tetovo, Tetovo
7. Enkelejdë Bytyçi, Yllka Bahtiri, Shpend Ismaili, Florim Idrizi, **Vjollca Shemshi**, “Using Heuristics to Evaluate User Experience in Educational Video Games” Journal of Natural Sciences and Mathematics of UT 8 | 15-16-2023, (15-16), 225-233, University of Tetovo, Tetovo
8. **Vjollca Shemshi**, Boro Jakimovski, Ivan Chorbev “Raising the Trust in Research and Education Digital Services Using Levels of Assurance Profiles, 4 th International Conference on Engineering and Applied Natural Sciences, November,2023 : Konya, Turkey.

3.2. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare:

1. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e parë të Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës, **Qershor, 2017**
2. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Konferencën e dytë të Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës, **22-23 Qershor, 2018**
3. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Kongresi ndërkombëtar për natyrën, shëndetin, shkencat dhe teknologjin, si dhe Konferencën e tretë të Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës, **15-17 Maj, 2019**
4. **Certifikatë** për trajnim e realizuar Për **ISO 9001 Quality Management System**, trajnim për menaxhimin e cilësisë e realizuar në Shkup, nr i certifikatës T-084/2020, Shkup, 07-08.10.2020
5. **Certifikatë** për trajnim me temë “Zgjedha inteligjente e rrjetit” në të cilin janë përfshirë “Trajnimi për ArcGIS për desktop”, “Trajnim për Smart Portal” dhe “Trajnim për konfigurim të Smart Portal” e realizuar në , **Qershor 2020**
6. **Certifikatë** për pjesëmarrjen në trajnimin me temë “Basic rules of cyber hygiene” e realizuar nga Cyber Security Program, CRDF Global in Ukraine,15.10.2021
7. **Certifikatë** për pjesëmarrje në Kongresi ndërkombëtar për natyrën, shëndetin, shkencat dhe teknologjinë, si dhe Konferencën e katërt të Shkencave Matematike Natyrore në Universitetin e Tetovës, **18-19 Maj, 2022**
8. **Certifikatë** për pjesëmarrje në konferencën ndërkombëtare për inxhinierinë dhe shkencat natyrore të aplikuara me 20-21 Nëntor 2023 në Konya /Turqi.

4. Veprimtaria profesionale-aplikative:

4.1. Libër nga fusha profesionale

1. Florim Idrizi, Florinda Imeri, Agon Memeti, Nexhibe Sejfuli-Ramadani, **Vjollca Shemshi**, Verda Misimi: „Qarqe Logjike“, Tetovë, 2023, ISBN 978-608-217-116-6.

4.2. Pjesëmarrje në aktivitete promovuese të fakultetit

Trajnim njëditor me nxënësit e shkollave të mesme, me temë “Krijimi i një uebfaqe duke përdorur aplikacionin Wordpress”, Maj 2023.

5. Përfundim dhe propozim:

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtaritë mësimore-arsimore, shkencore-hulumtuese, profesionale-aplikative dhe veprimtarinë me interes të përgjithshëm dhe konstaton se kandidatja **Ass. Mr. Vjollca Shemshi** në përputhje me Rregulloren e kritereve dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në bashkëpunëtorë në Universitetin e Tetovës, i plotëson kushtet për rizgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **asistent**.

Në bazë të aktivitetit të përgjithshëm të kandidatës nga zgjedhja e fundit e deri më tani, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësinë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës, t'i propozojë që kandidatja **Ass. Mr. Vjollca Shemshi** të rizgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **asistent** në lëmin e Informatikës, Zhvillimi i softuerit dhe bazat e të dhënave (11000, 11010 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në programin studimor Informatikë, drejtimi Shkenca kompjuterike të Fakultetit të shkencave Matematike Natyrore të Universitetit të Tetovës.

Tetovë, dhjetor 2023

Komisioni recensues:

1. **Prof. Dr. Florinda Imeri (kryetar)** – profesor inordinar pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

2. **Prof. Dr. Agon Memeti (anëtar)** – profesor inordinar pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

3. **Doc. Dr. Shpend Ismaili (anëtar)** – docent pranë Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në Universitetin të Tetovës

FORMULARI 1

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITUJ MËSIMORË-SHKENCORË,
SHKENCORË, MËSIMORË-PROFESIONAL

Kandidati: **Vjollca Shefket Shemshi**

Institucioni: **Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës**

Fusha shkencore: **Zhvillimi i Softuerit dhe baza e të dhënave (11000, 11010 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit)**

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR ZGJEDHJE NË TITULLIN BASHKËPUNËTOR – ASISTENT

| Nr. | KUSHTET E PËRGJITHSHME | Plotësimi i kushteve të përgjithshme po/jo |
|-----|--|--|
| 1 | Ka kryer studimet në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve akademike dhe ka fituar së paku 300 ECTS kredi | Po |
| 2 | Titulli i fituar – magjistër i shkencave në fushën përkatëse Emri i fushës shkencore: Informatikë | Po |
| 3 | Suksesi mesatar i arritur prej së paku 8,00 (tetë) në ciklin e parë dhe ciklin e dytë në studimet akademike, veçmas Suksesi mesatar në ciklin e parë: 9,15 . Sukseski mesatar në ciklin e dytë: 9,50 . | Po |
| 4 | Ka njohuri nga së paku një gjuhë të huaj 1. Gjuhë e huaj: Angleze 2. Emri i dokumentit: Certifikatë 3. Dhënësi i dokumentit: Qendra e gjuhëve dhe trajnimeve, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës 4. Data e dhënies së dokumentit: 13.11.2022 | Po |

REFERAT

PËR ZGJEDHJEN E NJË MËSIMDHËNËSI NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE DOCENT PËR LËMINË SHKENCORE MATEMATIKË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE NË UNIVERSITETIN E TETOVËS

Në bazë të nenit 173 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021). Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore në lidhje me konkursin për zgjedhje-rizgjedhje të shpallur me datën 18.11.2023 në Gazetën “Koha”, “Nova Makedonija” dhe Ueb faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023 sjell Vendim (nr. 15-2194/1) për formimin e komisionit recensues. Formohet komisioni për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëminë: **Ekuacionet Diferenciale dhe Të tjera** (10903, 10914 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencore-hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërjen si më poshtë:

1. Prof. Dr. Slagjana Brsakoska, profesor ordinar, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup,
2. Prof. Dr. Xhevair Beqiri, profesor ordinar, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti i Tetovës, Tetovë.
3. Prof. Dr. Gjorgji Markoski, profesor ordinar, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”, Shkup,

Komisioni në përbërje të plotë, si më sipër, pasi e kontrollon materialin e konkursit, titullit të lartë përmendur i paraqet këtë

RECENSION

Nga konkursi i publikuar më 18.11.2023 në gazetën “Koha” dhe “Nova Makedonija” mund të shihet se në të është shpallur për zgjedhje vendi i punës i një mësimdhënësi universitar në Programin studimor të Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në lëmitë: **Ekuacione diferenciale (10903) dhe Të tjera (10914)** (nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmive shkencore-hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit), në programin studimor Matematikë.

Pas kontrollimit të materialit të konkursit, nga dokumentacioni, komisioni konstatoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat, edhe atë Ylldrita Salihi, asistente në departamentin e Matematikës në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës.

I. TË DHËNA BIOGRAFIKE DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL

Ylldrita Salihi ka lindur në Tetovë, Tetovë, më 12.02.1992 ku edhe ka mbaruar shkollën fillore. Shkollën e mesme, Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç”– Tetovë, drejtimi matematikë natyror, kombinimi A (Matematikë-Fizikë), e ka kryer në vitin 2011. Pastaj, në vitin 2011 ka vijuar studimet universitare në Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore në Universitetin e Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut. Më datë 18.07.2015 mbrojti punimin e diplomës të titulluar “*Zinxhirët e Markovit të vazhdueshëm në kohë. Disa zbatime*”, me çka fitoi titullin **Profesor i matematikës** (shkalla VII/1).

Më pas, në vitin akademik 2015/16, ka regjistruar studimet e magjistraturës në departamentin e Matematikës në FSHMN, Universiteti i Tetovës, Republika e Maqedonisë së Veriut, ku në afat optimal i ka dhënë me sukses të gjitha provimet e parapara sipas plan-programit të studimeve. Punimin e magjistraturës me titull “*Interpretimi i strukturave ternare në planet afine dhe projektive*” e ka përfunduar dhe e ka mbrojtur me sukses më 07.09.2017 me çka ka marrë titullin **Magjistre e shkencave të matematikës**.

Pas kryerjes së ciklit të dytë të studimeve (magjistraturës), në vitin akademik 2017/18, kandidatja regjistron studimet e doktoraturës në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore në Universitetin “Kirili dhe Metodi”, Shkup, drejtimi Matematikë dhe Matematikë e zbatuar, ku më 19.05.2023 ka mbrojtur me sukses disertacionin e doktoraturës me titull: “*Krahasim analitik të disa metodave numerike për zgjidhje të përafërt të sistemeve jolineare diferenciale me derivate fraksionale*” dhe fiton gradën shkencore **Doktor i shkencave të Matematikës**.

Nga viti 2015 e deri më vitin 2016 ka punuar si profesoreshë e matematikës në shkollën e mesme “Nikolla Shtejn” Tetovë, nga viti 2016 deri në vitin 2018 ka punuar si arsimtare e matematikës në shkollën fillore “Istikball” Tetovë, kurse në vitin shkollor 2018/2019 ka punuar si profesoreshë e matematikës në gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” Tetovë. Si asistente part-time (bashkëpunëtore e jashtme) në Universitetin e Tetovës ka punuar nga viti 2015 deri në vitin 2019.

Nga viti 2018 deri më 2020 ka qenë bashkëpunëtore e jashtme në Universitetin Internacional Balkanik, Fakulteti Inxhinjerik dhe Arkitekturë. Në vitin 2019 zgjidhet *asistente* në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Tetovës në Programin studimor *Matematikë*.

Kandidatja për qëllime profesionale në mënyrë aktive shërbehet me gjuhët e huaja angleze, sërbe, gjermane dhe maqedone.

II. VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Gjatë periudhës që ka punuar si asistente, kandidatja Ylldrita Salihi ka mbajtur, ushtrimet nga kurset *Transformime Gjeometrike, Masa dhe Integrali, Ekuacionet Diferenciale të Zakonshme, Probabilitet, Hyrje në Gjeometrinë Diferenciale, Algjebër lineare II dhe Hapsirat Metrike* (programi studimor Matematikë), *Struktura Diskrete I & II* (programi studimor Informatikë), *Struktura Diskrete* (programi studimor Informatika në biznes), *Matematikë* (Programi studimor Biologji-Biokimi), *Matematika II* (programi studimor Kimi), Statistikë (Programi studimor: Matematika në biznes dhe financa) dhe *Matematika I, Matematika për nutricionistë dhe Matematika për shkencat e ushqimit* (Programet studimore: Teknologji ushqimore, Nutricioni dhe Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë ushqimore: Fakulteti i Shkencave Të Ushqimit). Ajo ka realizuar edhe ligjëratat nga kurset *Probabilitet, Ekuacionet Diferenciale dhe Hyrje në Gjeometrinë Diferenciale* (programi studimor Matematikë), *Matematikë* (Programi studimor Biologji: Biokimi) dhe *Matematika I, Matematika për nutricionistë dhe Matematika për shkencat e ushqimit* (Programet studimore: Teknologji ushqimore, Nutricioni dhe Menaxhimi me cilësinë dhe sigurinë ushqimore: Fakulteti i Teknologjisë ushqimore dhe të ushqyerit).

Në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën e zgjedhjes në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe bashkëpunëtor në Universitetin e Tetovës (Buletini i universitetit), kandidatja Ylldrita Salihi ka realizuar gjithsej **141.46 pikë** nga veprimtaria mësimore-arsimore.

III. VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

